



PROGESVERBAL XI /2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së XI (njëmbëdhjetë) për vitin 2022 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.11.2022
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të performancës për Komunën e Suharekës për vitin 2021;**
- 4. Raporti për procesin zgjedhor të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane në tërë territorin e Komunës së Suharekës;**
- 5. Diskutim për sensibilizimin e qytetarëve kundër dhunës në familje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë,hap debatin dhe ia jep fjalën zyrtarit ligjor pasi ka qenë pjesë e hartimit të këtij plani.

Avni Bytyqi - ne në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe strategjinë shtetërore kundër korrupsionit si dhe planin e veprimit kundër korrupsionit,i hartuar dhe miratuar nga qeveria e Kosovës e cila i obligon të gjitha institucionet shtetërore që të zhvillojnë dhe të miratojnë planet e integritetit,andaj puna jonë përmes grupit punues të themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës ka hartuar Planin e Integritetit për periudhën 2023-2027 dhe e ka paraqitur para jush për ta shqyrtuar dhe ta miratuar si organ kompetent. Ky plan synon të kontriboj në ndërtimin e një administrate komunale,profesionale,të zhvilluar dhe të qëndrueshëm në aspektin social,ekonomikë dhe lokal me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë,pa dallim.

Dardan Berisha - a ka pas Komuna një plan të tillë apo është duke e zhvilluar për herë të parë?

Avni Bytyqi - si plan të integritetit,Komuna është duke e bërë për herë të parë. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime .

Urim Suka - Përmbajtja që ky plan ka te çështja e korrupsionit,te çështja e investimeve tjera dhe duke u thirrë edhe në raportin e auditorit, le me kuptu që gjendja reale është e keqe dhe ka nevojë për një plan i cili i kthen Komunës integritet dhe parandalon këto dukuri të cilat po ndodhin. A është i formuar grupi punues si duhet të formohet apo formohet si don vet Kryetari apo ka një rregullore se si formohet grupi punues?

Avni Bytyqi - është rregullorja e 01/2017 e MAPL-së e cila tregon procedurat për hartimin e akteve nënligjore të Komunës,ku në kuadër të tyre bëjnë pjesë edhe strategjitë apo planet zhvillimore dhe aty i jep kompetencë dhe mandat Kryetarit të Komunës që ta formojë një grup punues për hartimin e këtyre dokumenteve dhe nuk e specifikon numrin e anëtarëve të grupit punues. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Urim Suka - falënderoj gr. punues dhe nuk kam asnjë kontestim. Unë kam dëshirë me pas dokumente të cilat ne i kthejmë në integritet në mënyrë që të kemi qeverisje ma të mirë dhe në të mirë të qytetarëve dhe Komuna ta ketë një emër më të mirë në kuptimin e vlerësimeve që bëhen,çoftë nga auditori i brendshëm apo i jashtëm. Mua më duket një lloj tendence e këtij pushteti,veçanërisht e Kryetarit për me hartu një plan sa për me figuru,e jo që po ka dëshirë me kthi në integritet të Komunës.

Kryesuesi - grupi punues e kanë përgatit një dokument i cili ka dobi dhe është mirë të dërgohet në Asamble.

Urim Suka - ne jemi për me përcjell për Asamble dhe atje e japim fjalën tonë për këtë dokument.

Dardan Berisha - a ka qenë dëshira dhe vullneti i Kryetarit për një plan të tillë apo si?

Avni Bytyqi - është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe strategjinë shtetërore kundër korrupsionit të cilat i obligojnë të gjitha institucionet që të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Dardan Berisha - a ka mundur edhe më herët të përfundoj ky plan?

Avni Bytyqi - ne e kemi planin e punës si ekzekutiv dhe si legjislativ dhe duhet ti përmbahemi planit të punës. Zyrta ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të performancës për Komunën e Suharekës për vitin 2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - pak a shumë jam mundu me lexu materialin për raportin e performancës së Komunave të Kosovës.A ka një raport në krejt Komunitat për të gjitha fushat bashkë,një tabelë?

Avni Bytyqi - çdo vit e kanë nda secilën Komunë veq e veq dhe na kanë njoftuar paraprakisht. Këtë vit ka ndodh për herë të parë që raporti u bë në total për të gjitha Komunitat. Ne e kemi obligim që ta sjellim në Asamble për diskutim dhe shqyrtim.

Urim Suka - më bëri përshtypje transparenca në Suharekë, kogja lartë e renditur. E kam pas një kërkesë në Asamble k a kalu një muaj dhe 2 muaj është dasht me prit për me marrë një raport. Kjo e tregon se sa transparent jeni.Ka shumë kontrata që mungojnë e që nuk janë të pasqyruara. Te pjesa e menaxhimit të projekteve,unë jam duke i kontrollu kontratat dhe është për keqardhje ndërsa vlerësimi është pozitiv.

Te mbrojtja e mjedisit, Suhareka renditet e 19-ta.Më vje keq për ata që e kanë bërë këtë raport.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Raporti për procesin zgjedhor të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane në tërë territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - ne pothuaj kemi bërë gati dy muaj deri në përfundim të këtij mandati. Ne si komision kemi bërë përpjekje,ku kemi dalë në të gjitha fshatrat dhe jemi mundu me qenë sa ma transparent.Kemi pas pakënaqësi në dy - tre fshatra,ku në ato fshatra kemi shku edhe nga dy herë.Janë disa fshatra në të cilat nuk kemi muajt me pas qasje, si Tvoran, Dragaqinë. Thirrja publike ka qenë për të gjithë qytetarët pa dallim.Kemi fillu me fshatin Mushtisht dhe kemi përfundu me fshatin Studenqan. Dardan Berisha tutje jep sqarime rreth raportit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave.

Kymete Bajraktari - Dardani në mënyrë të detajuar e pëshkruajti procesin.Unë nuk do të shtoj asgjë,përveq që Dragaqinën e kemi përfshi me Duhël, e cila ka qenë kërkesë e Dragaqinës.

Urim Suka - falënderoj komisionin për punën sepse ka qenë një punë e mundimshme. Ky komision e ka pas një rregullore që sipas neve si LDK e ka tejkalua rregulloren me thirrjen publike për qytetarët dhe e ka vështirësua. Unë kam bërë përpjekje si e kam pa këtë thirrje dhe kam kërkuar me e kthye në rregullore, por nuk keni dasht dhe keni vazhdu.Raporti që keni sjell është mirë me qenë ma serioz.Në takimin e dytë në Savrovë kanë marrë pjesë vetëm dy persona dhe janë marrë propozimet pa e pyet askënd. Faji i komisionit

nuk është mos pjesëmarrja e njerëzve por faji i komisionit është pse i ka pranuar emrat pa asnjë proces. Urim Suka flet edhe për disa parregullsi në disa vendbanime. Puna e këtij komisioni nuk është përmbyll ende. Janë disa vendbanime që nuk kanë Kryetar dhe nuk kanë këshill dhe ende mundet me pas ankesa dhe mendoj që duhet mu trajtu. Kërkoj që ky material mos të shkojë në Asamble por ju si komision me i trajtu vendbanimet që nuk janë kry dhe pasi të përmbyllet le të vije raporti.

Dardan Berisha - në moment që del në faqen zyrtare, ankesat janë 15 ditë. Gabim i yti është që je mundu me interferu në çdo fshat. E kemi respektuar rregulloren me përpikëri, janë procesverbalet për secilin fshat dhe mund ti shohësh procesverbalet. Dardan Berisha si anëtar i komisionit tutje jep sqarime rreth punës së komisionit.

Urim Suka - në asnjë vendbanim nuk kam interferu.

Avni Bytyqi - ky raport që ka ardh para jush ,nuk do të thotë që ka përfunduar gjithçka rreth këshillit të fshatrave dhe nuk ka proces zgjedhor që nuk ka pakënaqësi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

4 për.1 kundër,1 apstenim Miratohet pika 4

Pika 5. Diskutim për sensibilizimin e qytetarëve kundër dhunës në familje;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe ia jep fjalën nënkryetares.

Nënkryetarja - do të mundohem ta bëjë një raport dhe të nxjerri informacione sa më të sakta dhe në Asamble do ti shpërndajmë. Kjo pikë e rendit të ditës është vendosur jo pa qëllim për Asamble ,për arsye se është një fushatë 16 ditë aktivizëm kundër dhunës me baza gjinore. Kjo është një fushatë globale. Ne si grup i grave kemi bërë disa takime dhe në kuadër të kësaj fushate e kemi një agjendë,ku do të mbajmë disa takime dhe fushatën do ta fillojmë me një tryezë të rrumbullakët,pastaj do të fillojmë me vetëdijesimin në tri shkollat e mesme, pastaj do të vazhdojmë përmbylljen e fushatës me një marshim. Gjithashtu dua të ju njoftoj që me datë 24 do ta ripërtërijmë marrëveshjen me strehimoren në Prizren.

Takimi përfundoi: 14:10

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj